



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot

Bilisht, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Kanali ujites Poloske-Inonisht”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: Punime ndertimi per sisteme kullimi-45247112-8

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **19,810,165 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e dhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) leke pa tvsh financuar nga Buxheti i shtetit** i ndare ne vite si me poshte:

- ✓ Per vitin 2024, financimi ne vleren: 8,333,333.33 (tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) leke pa tvsh me burim financimi: Buxheti i Shtetit miratuar me VKM Nr. 226 date 09.04.2024 “ Për Shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “Menaxhimin i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”.
- ✓ Per vitin 2025, financimi ne vleren: 11,476,831.7 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë e një pikë shtatë) leke pa tvsh me burim financimi: Buxheti i Shtetit miratuar me VKM Nr. 226 date 09.04.2024 “ Për Shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi “Menaxhimin i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe në mbështetje të Nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertes nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël",

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për vitet 2021,2022,2023 ,ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë më e vogël se vlera e kontratës objekt prokurimi.**

*** Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenit 43, pika 2-b e VKM-se, nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se; "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;"

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar,ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Fondi limit = 19,810,165 (nëntëmbëdhjetë milion e tetëqind e dhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) leke pa tvsh

2.2.2. Per te vertetuar nje aktivitet te qendrueshem Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

***Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; i ndryshuar si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar . Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar).

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 si dhe këstin përkatës për vitin 2024, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës sipas adresave të regjistruar sipas QKB.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, që OE i ka shlyer detyrimet e taksave dhe të tarifave vendore për do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari përpara publikimit te njoftimit te fituesit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Vendosja e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për

operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoritetet vendore nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Bashkiak. Njësia e Prokurimit argumenton se kjo pike është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkia c) “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së perlloritur te kontrates që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit te kontrates që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

a.Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

b. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

- ✓ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontraten e bashkimit te operatoreve shoqeruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku te cilësohen punimet qe ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- ✓ Per kontratat e realizuara si Nenkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë:
 - a) Kontratë baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe
 - b) Miratimin zyrtar si nenkontraktor nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Ne rastin e Bashkimit te operatoreve ekonomike Operatoret duhet ti permbahen percaktimeve te nenit 88 te VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”,

Argumentimi: AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi,*

vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas DST, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Në rastet e Bashkimit të Operatoreve, për një vlerësimin sa më real të ofertave, është konstatuar se Komisionet e Vlerësimit të Ofertave hasin vështirësi për vlerësimin në mënyre sa më të drejtë të përvojës së ngjashme për rrjedhojë është e domosdoshme që Operatorët Ekonomik kur paraqesin kontrata të ngjashme, ku janë pjesë e një bashkimi operatorësh duhet të paraqesin gjithashtu dhe marrëveshjen e bashkëpunimit dhe prokurën e posaceme ku të përcaktohen përqindjet përkatëse.

Në rastet e Nënkontraktimit, kërkohet që vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit për marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga AK. Ky dokumentacion disponohet nga çdo operator ekonomik si në rastin kur ka qene palë në bashkimin e operatoreve ekonomik ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk sjell kufizim të pjesmarjes së operatoreve ekonomik në tender.

Të dyja këto kërkesa I vendosin në kushte të barabarta dhe u japin mundësi për vlerësim, të gjithëoperatoreve ekonomik ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit dhe marrëveshjet përkatëse të nënkontraktimit nuk janë të plotësuara sipas kërkesave ligjore.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- N.P - 1 A Punime gërmimi në tokë;
- N.P - 7 A Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- NS – 18 A Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar , nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , si dhe VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2 dhe 4). gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "**Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.** Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përllogaritur të kontratës.

NP - 1 A Punime gjurmimi në tokë

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me gfarëdo lloj mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv.

3.45/1 *Germim kanalesh toke e zakonshme me krahe,me seksion deri ne 0.75 m2*

3.46/1 *Germim kanalesh toke e forte me krahe,me seksion deri ne 0.75 m2*

3.87/b *Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale me gjeresi >2m toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke*

3.47/1b *Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke zak*

3.25/a *Germim me krahe me seksion te detyruar me gjeresi b>1m,h=1.5 m,toke e bute.*

3.25/c *Germim me krahe me seksion te detyruar me gjeresi b>1m,h=1.5 m,toke e forte.*

NP - 7 A Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv ne teresi aktivitetet që parashikon ky projekt përfshijnë ndertimin nga e para te ketij kanali ujites.Ndertimi i vepres se marjes. Veshjen me beton te seksionit terthor ne gjatesin e tij. Ndertimin e të gjitha veprave te artit nga e para pasi ne te gjithe gjatesin e gjurmes se kanalit ekzistues (aktualisht i gjithi jashte funksionit) ka probleme te medha me filtrimet e ujit, demtime te mureve te gurit etj. Gjithashtu projekti perfshin ndertimin e nje sifoni me tub metalik ne nje pjese te kanalit ujites.

| 4. PUNIME PER VESHJE KANALI | | |
|--|---------|---|
| 1 | 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 per veshje kanali |
| 2 | 2.258 | Nenshtrese zhavori t=10cm |
| 3 | AN-3 | Fugature llac cemento M - 50, cdo 3ml |
| 4 | 2.37/5a | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km |
| 5. PUNIME PER TUBAT E ÇELIKUT | | |
| 1 | 3.25/a | Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b < 1 m, h=1.5 m, toke e zak. |
| 2 | 2.258 | Nenshtrese zhavori t=10cm |
| 3 | 4.60 | Tub Celiku D 600mm/t=6.55mm (98.81 kg/ml) |
| 4 | 2.37/5a | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km |
| 6. PUNIME PER PORTALET H+D TUB E ÇELIKU | | |
| 1 | 3.25/a | Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b < 1 m, h=1.5 m, toke e zak. |
| 2 | An.1 | Mbushje, rafshim,ngjeshje me material te germuar me pare |
| 3 | 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 per themelet dhe muret |
| 4 | 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 per veshje kanali |
| 5 | 3.625 | H / Izolim me emulsion, 1 K. Katr.importi cilesia 1 per sifonin e ri |

| | | |
|---|---------|---|
| 6 | 3.288 | F V hekur betoni i zakonshem per zgaren |
| 4 | 2.37/5a | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km |
| 8. PUNIME PRIZE 40X40 PER MARRJE UJI | | |
| 1 | 3.25/a | Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b < 1 m, h=1.5 m, toke e zak. |
| 2 | 3.47/1b | Mbushje, rafshim,ngjeshje me material te germuar me pare |
| 3 | 3.205 | N/shtrese zhavori 10cm |
| 4 | 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 per themelet dhe muret |
| 5 | 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 per veshje kanali |
| 6 | An-4 | F.V.Porte 40x50 komplet me mekanizem ngrites |
| 4 | 2.37/5a | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km |

Për punimet speciale të ndërtimit :

NS – 18 A Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh

Kjo kategori licence i referohet punimeve topografike të parashikuara në projekt.

Kërkohet sepse gjatë zbatimit të projektit do të ketë punime topogjeodezike dhe matje per te bere azhornimin e zones dhe ndjekjen e projektit me kuota te percaktuara.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkuar | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|----------------------------|---|---|--|---|
| N.P - 1 A | Punime germimi në tokë | 3.45/1;3.46/1;3.87/b;3.47/1b;3.25/a;3.25/c | 0- 20 milion lekë | 2,236,263.72 Lek |

| | | | | |
|----------|---|--|-------------------|------------------|
| NP – 7 A | Ujsjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje | Ne teresi aktivitetet që parashikon ky projekt përfshijnë ndertimin nga e para te ketij kanali ujites.Ndertimi i vepres se marjes. Veshjen me beton te seksionit terthor ne gjatesin e tij. Ndertimin e të gjitha veprave te artit nga e para pasi ne te gjithë gjatesin e gjurmes se kanalit ekzistues (aktualisht i gjithi jashte funksionit) ka probleme te medha me filtrimet e ujit, demtime te mureve te gurit etj. Gjithashtu projekti perfshin ndertimin e nje sifoni me tub metalik ne nje pjese te kanalit ujites. | 0- 20 milion lekë | 15,495,061 leke |
| NS -18 A | Punime topogjeodezike | <p>II. PUNIME GERMIMI DHE PRITAT MALORE</p> <p>Germim kanalesh toke e zakonshme me krahe,me seksion deri ne 0.75 m2</p> <p>Germim kanalesh toke e forte me krahe,me seksion deri ne 0.75 m2</p> <p>Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale me gjeresi >2m toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke</p> | 0- 20 milion lekë | 2,236,263.72 Lek |

| | | | | |
|--|--|--|--|--|
| | | <p>Mbushje, rafshim,ngjeshje me tokmak elektrik, cdo 30 cm, toke zak</p> <p>Germim me krahe me seksion te detyruar me gjeresi $b > 1m, h = 1.5 m$,toke e bute.</p> <p>Germim me krahe me seksion te detyruar me gjeresi $b > 1m, h = 1.5 m$,toke e forte.</p> <p><i>Gjate zbatimit te projektit duhet te behen matje dhe azhornimi i zones dhe ndjekjen e projektit me kuota te percaktuara.</i></p> | | |
|--|--|--|--|--|

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te paktën:

- a. 1(nje)inxhinier ndertimi
- b. 1 (një) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë te siguruar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **muajin e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës,Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndyshuar , *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e*

nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Ne preventiv janë parashikuar punime për të cilat është e nevojshme kërkesa e vendosur nga Ak për një Inxhinieri i ndertimit i cili duhet të organizojë punën në zbatim, dhe kryerjen e punimeve si dhe zbatimi i sipas projektit të zbatimit.

| |
|--|
| Gabiona me rrjete teli të zinguar e gure kave 1x1x1 m |
| Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 |
| Struktura monolite betoni C 16/20 |

Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

Ndërhyrjet të cilat do të behen janë ndërtimi I vepres së marjes.Germimi / mbushja për krijimin e seksionit të kanalit të cilat janë punime që kërkojnë domosdoshmerisht praninë e një inxhinieri topograf ose profesionet ekuivalente të afte I cili do të ndjehet për të bërë azhurnimin e zonës dhe ndjekjen e projektit me kuota të përcaktuara për të ruajtur kualitetin e ndertimit të ri dhe parandalimin e devijimeve.

2.3.2 Vetdeklarimin nga inxhinieri i ndertimit dhe Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik, se janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020”Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP”

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier ndertimi dhe të deklarojë se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit..

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për drejtuesin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierin në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ai është përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për **muajin e fundit** duhet të jetë **20 (njezet)**.

Lidhur me këte pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatase E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 20 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendim nr.216 DT 13.04.2023 „Sistemi I Integruar I Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim“ Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës,që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën e cila ka nje afat prej 16 muajsh.

Konkretisht sipas analizes teknike rezulton se nevojiten: Teknik Ndërtimi2 (dy), Hekurkthyes 1 (Nje),Karpentier 6 (Gjashte), Hidroizolues 1 (nje), Eskavatorist 1(nje), Shofere Kamioni 1 (Nje), Punetore te tjere 6 (gjashte), + 2 (dy) inxhineret= 20 punonjes total

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj eshte kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë, ku nga këta të jenë të paktën:

| | |
|-------------------|-------------|
| - Teknik Ndërtimi | 2 (dy) |
| - Hekurkthyes | 1 (Nje) |
| - Karpentier | 6 (Gjashte) |
| - Hidroizolues | 1 (nje) |
| - Eskavatorist | 1 (Nje) |
| - Shofere Kamioni | 1 (Nje) |

Manovratori duhet të jete punonjës te specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda(Eskavatorist) dhe (shofer kamioni) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor ndersa per teknikun e ndertimit duhet te paraqitet diploma e shkolles/deshmi nga organe/institute te akredituar.

✓ **Manovratori mund te jete i kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate ne rastin kur makinerite jane me qera.**

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e ketyre kriterëve për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në si dhe mjeteve të kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

Kerkesa që punonjësit e me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik (te vlefshme) të leshuara nga organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë bazuar duke vlerësuar se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deshmi për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme sipas dispozitave të ligjit nr.8734, datë 1.2.2001 për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike” i ndryshuar

Kerkesa për deshmitë e manovratoreve bazohet në Urdhërin e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”

Specialistët e mesipër janë vendosur në përputhje me llojin e kontratës, zerat e punimeve dhe objektin që ndërtohet me një numër të mjaftueshëm për realizimin me sukses të punimeve.

1.Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit. Për të ndjekur punimet në terren dhe për të organizuar dhe kontrolluar punëtoret (duke patur parasysh numrin e punëtoreve në pikën është vlerësuar si e nevojshme prania e 2 teknikeve të ndërtimit.

2. 1(Një) Hekurthyes sepse në preventive janë parashikuar punime për furnizim vendosje hekuri për veprat e artit dhe punime për ndërtim gabionash.Keto punime së bashku me zera të tjere të parashikuar në preventiv

| | | |
|-------|---|-----------|
| 3.288 | F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm | 0.386 Ton |
| 3.287 | F V hekur betoni i zakonshem Ø 6-10mm | 0.13 Ton |
| 3.331 | Gabiona me rrjete teli të zinguar e gure kave 1x1x1 m | 5 m3 |

3- 6(Gjashtë)karpentiere :Ak e ka gjykuar të arsyeshme angazhimin e 6 karpentierëve gjatë zbatimit të punimeve duke ju referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe në projektin e zbatimit. Janë parashikuar sasi të konsiderueshme punimesh për ndërtim veprash arti (ura për kembesore, ,struktura prej betoni etj).

| | | | |
|-------|-----------------------------------|----|-------|
| 3.243 | Struktura monolite betoni C 16/20 | m3 | 906.1 |
| 3.249 | FV soletone b/a C 16/20 | m3 | 4.3 |

• **Manovratoret dhe Shoferet**

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendim nr.216 DT 13.04.2023 „Sistemi I Itegruar I Manualit Te Cmimeve Ne Ndertim „Konkretisht numri I drejtuesve eshte ne perputhje numrin dhe llojin e makinerive qe perkojne me oret e punes sipas zerave te analizes teknike dhe grafikun e punimeve eshte vendosur edhe numri i manovratoreve dhe shoferëve . Persa i perket numrit te shoferave, analiza e e zerave sipas manualit nuk na dikton kohen qe duhet per te transportuar materialet e ndertimit, mbetjet inerte etj

2.3.8 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

| Nr. | Mjete | Sasia | Gjendja |
|-----|--|--------|------------------------|
| 2 | Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 7 ton | 1 copë | Në pronësi ose me qera |
| 3 | Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton | 1 copë | Në pronësi ose me qera |
| 4 | Ekskavator me goma ose me zinxhire | 1 copë | Në pronësi ose me qera |
| 5 | Autobot uji ose Depozite uji 500 l | 1 copë | Në pronësi ose me qera |
| 6 | Tomak ngjeshes elektrik | 2 copë | Në pronësi ose me qera |
| 7 | Paisje per matje topografike | 1 copë | Në pronësi ose me qera |
| 9 | Moto gjenerator | 1 copë | Në pronësi ose me qera |
| 11 | Betoniere kantieri | 2 copë | Në pronësi ose me qera |

Pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 ”Per miratimin e Rregullores per sigurine ne kantier”, si më poshtë vijon:

2

| Nr . | Pajisje teknike | Sasia | Gjendja |
|------|--|---------|------------------------|
| 1 | Helmetë mbrojtëse për kokën | 20 copë | Në pronësi ose me qera |
| 2 | Jelekë me shirita fosforishentë | 20 copë | Në pronësi ose me qera |
| 3 | Fikëse zjarri të lëvizshme ≥ 5 kg | 2 copë | Në pronësi ose me qera |
| 4 | Tabela Sigurimi Teknik | 10 copë | Në pronësi ose me qera |
| 5 | Kuti e Ndhmës së shpejtë | 2 copë | Në pronësi ose me |

| | | | |
|--|--|--|------|
| | | | qera |
|--|--|--|------|

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike Operatori duhet te paraqese:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme)
- v. Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit. ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes.

Mjet transporti vetshkarkues ≥ 7 ton nevojitet per transportin e dherave te dala nga germimet si dhe transportin e cakullit.

Mjeti I transportit deri ne 3.5 ton nevojitet per transportin e materialeve te ndertimi si cemento ,hekur etj.

Betoniere nevojitet për përgatitje e llaçeve dhe betoneve zëri në preventiv *Struktura monolite betoni C 16/20*

Eskavatori me goma ose zinxhir nevojitet per germim dheu sipas zerave ne preventiv

Paisje per matje topografike per kryerjen e rilevimit sipas kuotave te percaktuara ne projekt.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fitesit do t’i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT: